



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 05.07.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 117/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesave për ri-shqyrtim të datës 30.06.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **DWH-ALBANIA SH.P.K** dhe Operatori Ekonomik **DWH-KOSOVA SH.P.K**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **Furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station**, me Nr. të Prok: **632-20-7318-1-2-1**, nxjerr:

### VENDIM

- 1. Refuzohen si** të pa bazuara kërkesat për ri-shqyrtim të dt. 30.06.2021, të parashtruara nga Operatori Ekonomik **DWH-ALBANIA SH.P.K** dhe Operatori Ekonomik **DWH-KOSOVA SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **Furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station**, me Nr. të Prok: **632-20-7318-1-2-1**, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 29.06.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë **29.06.2021**;
- 3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit;**
- 4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.**

## Arsyetim

Operatori Ekonomik DWH-ALBANIA SH.P.K dhe Operatori Ekonomik DWH-KOSOVA SH.P.K., me datë 30.06.2021, kanë parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station”, me Nr. të Prok: 632-20-7318-1-2-1.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 05.07.2021, ka shqyrtuar Kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti kontraktues, me dt.23.04.2021, ka kërkuar interpretim ligjor nga KRPP-ë, dhe ka vepruar sipas këtij interpretimi.



Republika e Kosovës/Republika Kosovo/Republic of Kosovo  
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik  
Regulatorna Komisija Javne Nabavke  
Public Procurement Regulatory Commission



Për:	Xhënel Hallosmani Zyra e Prokurimit KK-Gjakovë
Të bërë:	Osman Vishaq – Kryetar Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
CC	Arbora Cakoli – Liza Kordinatore e Departamentit të Rregullave - KRPP
Nga:	Antigona Rexhepi-Sheqiri Zyrtare Ligjore e Departamentit të Rregullave-KRPP
Lënda:	Përgjigje Kërkesës për Interpretim të dt. 23.04.2021
Data:	20.05.2021

Të nderuar,

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-217, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në të dhënat e shkresës suaj, KRPP sqaron si më vijim:

Dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe ato të legjislacionit dytësor të prokurimit publik, nuk e trajtojnë në mënyrë decisive një situatë të tillë të përshkruar në shkresën tuaj.

Në nenin 71 të LPP-së, është e definuar, se një Operator Ekonomik nuk mund të ofertojë në një aktivitet të prokurimit dhe të prezantojë ofertën e tij si individual (si i vetëm) dhe si anëtarë i një grupi në të njëjtën kohë në një aktivitet të prokurimit.

Në analogji me këtë nen dhe duke u bazuar në nenin 87 të LPP-së ( i cili ndër të tjera e autorizon KRPP-në që të jep opinionet dhe të koshillojë Autoritetet Kontraktuese dhe Operatorët Ekonomik për veprimet e tyre), KRPP konsideron se nëse në një aktivitet të prokurimit një pronar ka dorëzuar më shumë se një tender në emër të kompanive pronar i të cilave është i njëjti pronar është e papranueshme.

Me respekt,

Vërejtje: Interpretimi i dhënë nga KRPP, i referohet vetëm pyetjes së parashtruar nga ana juaj dhe asçesi nuk i dedikohet aktivitetit të prokurimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve nga publikimi i Vendimit në platformën elektronike <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>**

Kopje: Grupi i OEt Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës

Faton Gutaj  
  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

